

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**NDALIMI I HERETIZIMIT
TË MYSLIMANËVE
DHE I NËPËRKËMBJES
SË SHENJTËRIVE TË YMETIT
ISLAM**

*(Sipas ligjeve fetare, mendimeve të autoriteteve fetare dhe
dijetarëve myslimanë shi'itë)*

Tiranë, 2015



**Titulli: Ndalimi i heretizimit të myslimanëve
dhe i nëpërkëmbjes së shenjtërive të Ymetit Islam**

*(Sipas ligjeve fetare, mendimeve të autoriteteve fetare dhe dijetarëve myslimanë
shi'itë)*

E përktheu: Vullnet MERJA

E redaktoi: Jerida KULLA

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie FEZA

Kopertina: Sabrie FEZA

E botoi: Shoqata "FLLADI"

Tiranë, 2015

Hyrje

HERETIZMI NË MENDIMIN ISLAM

Prapaskenat historike të heretizmit

a) El khauarixh, grupi i parë që ngriti moton e heretizmit

Shkëndija e parë e heretizmit në botën islame doli nga grupi *El Khauarixh*.

Ky grup i humbur konsiderohet si rryma e parë devijuese në botën islame, i cili e shtjellonte besimin në formë të gabuar dhe shkatërruese.

Profeti ynë fisnik, Muhamedi (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka lajmëruar për daljen e këtij grupi devijues e humbës. Ai ka thënë: "*Largohen nga feja, ashtu siç largohet shigjeta nga harku.*"¹

¹Shih "El Milel ue Nihel", i Muhamed ibn Abdul Kerijm Esh Shehristanij, vëll. 1, f. 134.

Khauarixhët larguan veten e tyre nga Islami gjatë Luftës së Sifinit. Në atë kohë ata ishin thjesht grup politik, mirëpo gradualisht zgjodhën parime besimi të veçanta, me qëllim që të justifikonin punët dhe veprat e tyre të palogjikshme. Me gjithë praninë e besimeve të shumta, çështja më ndikuese, që çoi në lindjen e besimeve të tyre, të medhhebeve të tjera, është leximi ekstrem i kuptimit të besimit të khauarixhët. Ky lexim ekstrem bëri që ata t'i quajnë të pafe të gjithë myslimanët. Bazuar në këtë, pa asnjë mëdyshje, khauarixhët janë grupi i parë heretik, që është shfaqur në botën islame.²

Parimet e besimit të khauarixhëve u themeluan në kohën e Ezarikatut³ pas “gjykatës së parë.”⁴

Khauarixhët besojnë se besimi përbëhet nga tri pjesë: vërtetësia gjuhësore (pohimi), vërtetësia me zemër dhe vërtetësia me gjymtyrë (përfundimi). Bazuar në këtë përshtkrim e njohje, nëse një njeri beson Allahun e Madhëruar me gjuhën e tij, me zemrën e tij dhe bën gjynahe, ai ka humbur besimin e tij dhe është bërë

² Për t'u njohur më shumë rreth mënyrës së daljes së lëvizjes së khauarixhëve e grupeve të tjera, që janë me të, shih librin “El Firek bejnel Firek”, i Tahir ibn Muhamed el Bagdadij, f. 72-95.

³ Ezarikatu është grupi që udhëhiqej nga Nafi ibn el Ezrek. Ai konsiderohet një prej grupeve më të mëdhenj të khauarixhëve për nga fuqia dhe numri. Shih librin “El Firek bejnel Firek”, i Tahir ibn Muhamed el Bagdadij, f. 82.

⁴ Gjykata e parë (el mahkametul ulaa) konsiderohet grupi i parë khauarixh, që u themelua në kohën e kundërshtimit të tahkimit. Kjo është arsyeja se pse quhen me këtë emër. Sigurisht, ngjyrat e besimit të khauarixhëve nuk kanë qenë të qarta kur ka dalë ky grup. Shih librin “El Firek bejnel Firek”, i Tahir ibn Muhamed el Bagdadij, f. 72-74.

jobesimtar, mohues. Bazuar në këtë pikëpamje khauarixhët besonin si vijon:

a- Kushdo që i kundërshton, konsiderohet jo vetëm kafir, por edhe mushrik.⁵

b- Ata khauarixhë që nuk shkojnë në luftë, konsiderohen të pafe.⁶

c- Ato vende që i kundërshtojnë khauarixhët, konsiderohen “vendqëndrime të kufrit”.⁷

d- Vrasja e të pafeve është uaxhib (obligim). Po ashtu, vrasja e fëmijëve dhe e grave të tyre është e lejueshme. Fëmijët e tyre janë përherë në Xhehenem.⁸

Khaurixhët i sprovonin njerëzit që bashkoheshin me ushtrinë e tyre, duke i urdhëruar që të vrisnin një nga robërit e rënë në dorën e tyre. Nëse e vrisnin, e quanin pjesë të tyre. Por nëse nuk e bënin, i akuzonin se ishin mushrikë, hipokritë dhe i vrisnin ata.⁹

Ky grup i humbur vrau Prijësin e Besimtarëve, Ali ibn Ebu Talibin (Paqja qoftë mbi të!), me argumentin se mohoi takimin. Pasi Ali ibn Ebu Talibi pranoi këtë, u lejua derdhja e gjakut të tij!¹⁰

⁵ Tahir ibn Muhamed el Bagdadij, “El Firek bejnel Firek”, f. 83.

⁶ Tahir ibn Muhamed el Bagdadij, “El Firek bejnel Firek”, f. 83.

⁷ Tahir ibn Muhamed el Bagdadij, “El Firek bejnel Firek”, f. 84.

⁸ Tahir ibn Muhamed el Bagdadij, “El Firek bejnel Firek”, f. 83.

⁹ Tahir ibn Muhamed el Bagdadij, “El Firek bejnel Firek”, f. 83.

¹⁰ Khaurixhët kanë besime të tjera, ndër to sovraniteti i Allahut bazuar në moton “la hukme il’lallah”, sundimi i takon vetëm Allahut. Ne nuk e kemi cekur sqarimin e kësaj teme, sepse nuk ka lidhje me tematikën që po trajtojmë. Për t’u njohur më shumë, shih librin “El Milel uen Nihel”, i Abdul Kerijm Esh Shehristanij, vëll. 1, f. 131.

Këto besime të pabaza bënë që ky grup i humbur të derdhë gjakun e myslimanëve, të vjedhë e të grabisë pasuritë e tyre dhe të vërë dorë mbi nderet e tyre. Po ashtu, bënë që pasuesit e tyre të thonë se të gjitha vendet islame janë “vendqëndrime të kufrit!”. Në kohën që ata interesoheshin sa për sy e faqe për rregullat islame, shumë prej tyre faleshin natën dhe agjëronin ditën. Mirëpo ata, ashtu siç i përshkroi Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kanë dalë nga feja, për shkak të qëndrimit të tyre, të besimit të tyre. Sot atyre u ka mbetur vetëm emri.

Masakrat ndaj myslimanëve në shekullin e katërt

Para shekullit të katërt, pas zhdukjes së khauarxhëve, heretizmi nuk ka qenë i përhapur në mesin e myslimanëve. Edhe pse kjo gjë përmendet nga gjuhët e disave, ai nuk zbatohet dhe as nuk ndikonte në lejimin e derdhjes së gjakut të myslimanëve e as në lejimin e marrjes së pasurive të tyre.

Në shekullin e katërt u shfaq një person, Hasan ibn Ali ibn Khalef el Berbeharij, i lindur në vitin 233 ose 252 Hixhri, që ringjalli heretizmin në botën islame. Ai pretendonte se ishte prej *medhhebit hanbeli* dhe e shfrytëzoi këtë gjë për t’i quajtur të pafe myslimanët.

Ibn Ethijri, në historinë e tij, rreth ndodhive të vitit 323 hixhri, thotë: “...udhëheqësit khauarxhë kur gjenin verë, e derdhnin, kur gjenin këngëtare, e rrihnin atë,

thyenin veglat e muzikës dhe ndalonin shitblerjen e tyre. Kur ecnin burrat me gratë dhe të rinjtë në rrugë, ata i shikonin, i ndalonin dhe i pyesnin se kush ishin, duke i lajmëruar. Nëse nuk i tregonin, i rrihnin dhe i dërgonin te kryexhandari dhe dëshmonin kundër tyre për imoralitet...”¹¹

Sipas disa transmetimeve të tjera, në të njëjtin vit, El Berbeharij dhe përkrahësit e tij sulmuan dyqane, i dogjën ato, si kundërpërgjigje për arrestimin e disa përkrahësve të tij.¹² Për këtë u dha urdhër për arrestimin e tyre. El Berbeharij u arratis, kurse përkrahësit e tij u përballën me dënime të ashpra.¹³

Pasojat e heretizmit në kohën e sotme

Pas zhdukjes së grupit të udhëhequr nga El Berbeharij, zjarri i përçarjes u shua në botën islame, edhe pse disa persona, si ibn Tejmija, u përpoqën ta ringjallnin e ta përhapnin përsëri në mesin e myslimanëve. Këto përpjekje mbetën vetëm në korniza teorike dhe nuk u vunë në praktikë. Kështu që nuk u derdh gjaku i myslimanëve e as nuk u kryen masakra ndaj tyre. Por në shekullin e dymbëdhjetë hixhri, u rindez zjarri i heretizmit dhe me

¹¹ Ibnul Ethijr”, “El Kamilu fi tarijkh” vëll. 7, f. 113-114. Ebu Ali ibn Meskeuij në librin “Texharibul Umemem ue teakibul himem”, vëll. 5, f. 183.

¹² Muhamed es Saulij el Eurak, “Akhabaru Er Radhij bil’lah”, f. 65.

¹³ Shemsudijn Ebu Abdilah edh Dhehebij, “Sijer A’lamun Nubela”, vëll. 15, f. 90.

flakët e tij dogji shumë myslimanë, veçanërisht Ehli Sunetin.

Sot shikojmë pasuesit e heretizmit të vrasin myslimanët, bazuar në të njëjtat mendime devijuese e humbëse të të parëve të tyre. Ata kryejnë gjakderdhjen e myslimanëve me metodat më të shëmtuara e më të ashpra. Madje as fëmijët e as femrat nuk i shpëtojnë ashpërsisë së tyre. Ndërkohë që mësimet islame e ndalojnë rreptësisht heretizmin. Po ashtu, dijetarët e mëdhenj islamë e kundërshtojnë këtë vepër të shëmtuar.

Heretizmi në mendimin islam

a- Papreksshmëria e njeriut në Islam

Sipas parimeve të Islamit, jeta e njeriut, pasuria dhe nderi i tij janë të respektuara dhe nuk lejohet cënimi i tyre. Allahu i Madhëruar thotë: **“Prandaj Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s’ka vrarë njeri, ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve. Të dërguarit tanë u sollën shenja të qarta, por shumë nga ata, edhe pas kësaj, i kaluan tërë kufijtë me të këqija në Tokë.”**¹⁴

¹⁴ Sure “El-Maide”, ajeti 32.

b- Paprekshmëria e myslimanit

Përveç paprekshmërisë që Allahu ia ka dhuruar njeriut në përgjithësi, besimtari ka gradën më të lartë të shenjtërisë dhe vrasja e tij është shkak i dënimit të rëndë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Kushdo që vret një besimtar me qëllim, ndëshkimi i tij është Xhehenemi, në të cilin do të qëndrojë përgjithmonë. Allahu është zemëruar me atë, e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh.”**¹⁵

Nga ana tjetër, etaloni i besimit, nga pikëpamja e Kur'anit, është shfaqja e simboleve të Allahut dhe pohimi i Islamit. Në këtë gjendje, nuk lejohet agresioni, dhuna armiqësia ndaj atyre që pohojnë Islamin. Allahu i Madhëruar, në Librin e Tij të Shenjtë, thotë: **“O ju që keni besuar! Kur të shkoni në luftë, në rrugë të Allahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: “Nuk je besimtar”, me qëllim që të fitoni kënaqësi të kësaj jete...”**¹⁶

Shkaku i zbritjes së këtij ajeti është veprimi i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), kur, nga Beteja e Khajberit, dërgoi Usama ibn Zejd në disa fshatra jehudite, nga ana e Fedekut, për t'i ftuar ata në Islam. Merdas ibn Nehijk El Fedekij, kur dëgjoi për këtë, mblodhi familjen dhe të afërmit e tij nga ana e malit dhe filloi të thotë: **“Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut!”** Pranë tij kaloi Usama

¹⁵ Sure “En-Nisa”, ajeti 93.

¹⁶ Sure “En-Nisa”, ajeti 94.

ibn Zejdi, i cili e preu në besë dhe e vrau atë. Kur u kthye te Profeti, e lajmëroi për atë që bëri. Profeti i tha: *"Vrave burrin që dëshmoi se s'ka Zot tjetër përveç Allahut e unë jam i Dërguari i Allahut?!"*

Usama i tha: *"O i Dërguari i Allahut! Ai e tha atë për t'u mbrojtur nga vrasja."*

Profeti i tha: *"Ti nuk e hape mbulesën e zemrës së tij, as nuk e pranove atë që tha me gjuhën e tij dhe as nuk e ke ditur se çfarë ka pasur në brendinë e vetes së tij."*¹⁷

Ka shumë hadithe që i ndalojnë myslimanët t'i quajnë të pafe pasuesit e tjerë të ymetit të tij. Profeti Muhamed e ka sqaruar kufirin e besimit e të mosbesimit (kufrit), duke thënë: *"Jam urdhëruar t'i luftoj njerëzit derisa të thonë "La ilahe il'lallah". Nëse e thonë, falin namazin tonë, drejtohen nga Kibla jonë dhe i therin kafshët me therjen tonë, na është ndaluar vrasja e tyre dhe marrja e pasurisë së tyre."*¹⁸

Në Betejën e Khajberit, kur i Dërguari i Allahut ia dorëzoi flamurin Prijësit të Besimtarëve, Aliut (Paqja qoftë mbi të!) që të hapte murin mbrojtës të Khajberit, i tha: *"Unë do t'ia jap këtë flamur një burri që e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe Allahu do ta çlirojë këtë me dorën e tij..."*

Profeti e thirri Aliun dhe ia dorëzoi flamurin, duke i thënë: *"Shko e mos u kthe derisa Allahu të të japë triumfin..."*

Aliu i tha: *"O i Dërguari i Allahut. Për çfarë t'i luftoj njerëzit?"*

¹⁷ Muhamed Bakir El Mexhlisij, "Biharul Anuar", vëll. 22, f. 92.

¹⁸ Sahihu Buhari, "Namazi", K. 28, f. 108, hadithi 392.

Profeti i tha: "Luftoi derisa të dëshmojnë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Tij. Nëse e bëjnë këtë, të ndalohet ty gjaku dhe pasuria e tyre..."¹⁹

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Mënjahuni nga ata që thonë: 'S'ka Zot tjetër përveç Allahut!'", dhe mos i quani të pafe ata për një gjynah. Ai që i quan ata të pafe, është më afër mosbesimit (kufrit)."*²⁰

Gjithashtu, Sematu ibn Mehram ka përcjellë nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!), thënien e tij: *"Islami është dëshmia se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe pohimi e vërtetimi i të Dërguarit të Allahut. Me atë mbrohen gjakrat, zbatohen martesat, trashëgimitë dhe grumbullohen njerëzit."*²¹

Vërtet, ka shumë teste hadithesh nga shi'at dhe sunitët që i ndalojnë myslimanët t'i quajnë të pafe të tjerët. Mirëpo këtu nuk është vendi që të përmenden të gjitha.²²

c- Dijetarët myslimanë dhe heretizmi

Dijetarët islamë e qortojnë, e kundërshtojnë dhe e dënojnë ashpër heretizmin. Shumë prej dijetarëve shi'itë kanë nxjerrë fetva për ndalimin e heretizmit të myslimanëve të tjerë, ndër to shejkh Saduk²³, shejkh

¹⁹ Muslim Nijshaburij, Sahihu Muslim, vëll. 4, f. 1872. Fadailu Sahabeh, hadithi 33.

²⁰ Sulejman ibn Ahmed et Tabaranij, "El Mu'xhul Kebijr", vëll. 12, f. 372.

²¹ Kulejnit, "Usulul Kafij", K. "Besimit dhe mosbesimi", vëll. 2, f. 19.

²² Për më tepër shih, El Ijmanu uel Kufr, i ajatullah Xha'fer Subhani, f. 63-64. Ai ka përmedur disa hadithe rreth kësaj çështjeje.

²³ Muhamed ibn Ali ibn Babeueji, i njohur me emrin shejkh Saduk, në librin "El Hidajetu fil Xheuamiul fikhijeh", f. 47.

Muhamed Hasan en Nexhefij²⁴, Ajatullah Sejid Muhsin el Hakijm²⁵, Ajatullah Muhamed Takij El Amulij²⁶ dhe eruditi Mexhlisij.

Esh Shejkh Saduku thotë: “Islami është pohim me dy dëshmi. Besimi (imani) është pohim me gjuhë, lidhje me zemër dhe veprim me gjymtyrë. Kush dëshmon dy dëshmitë, i është mbrojtur pasuria dhe gjaku i tij...”²⁷

Ajatullahu i madh, Es Sejid Khui, ka thënë: “Islami bazohet te pastërtia. Respekton pasurinë dhe gjakun. Grupet islame besojnë në Njësimin e Allahut, në profetësinë dhe në Ringjalljen.”²⁸

Ndërsa medhhebet e Ehli Sunetit, Ibn Hazm, i ka ndarë mendimet heretike në disa grupe. Ai ka thënë: “Ebu Muhamedi ka thënë: ‘Njerëzit kanë mendime të ndryshme për këtë çështje. Disa thonë se ai që i kundërshton ata në ideologji apo në diçka prej çështjeve të fetvave, është i pafe (kafir). Një grup tjetër ka thënë se ai është kafir në disa prej tyre dhe fasik (i papërgjegjshëm) në disa të tjera, në varësi të asaj që çuan mendimet dhe supozimet e tyre. Një grup i tretë ka thënë se ai që i kundërshton ata në çështjet e besimit, është qafir dhe ai që i kundërshton ata në çështjet e rregullave dhe të adhurimeve, nuk është as qafir, as fasik,

²⁴ Muhamed Hasan En Nexhefij, “Xheuahirul Kelam fi sherh sheriul islam”, vëll. 6, f. 58.

²⁵ Es Sejjid Muhsin El Hakijm, “Mustemsekul Uruetul Uthka”, vëll. 2, f. 123

²⁶ Muhamed Takij el Amulij, “Misbahul Huda fi sherhil Uruetul Uthka”, vëll. 1, f. 410-411.

²⁷ Shejkh Sadukut, “El Hidajetu”.

²⁸ Sejid Abul Kasim El Khui, “Et Tankijh”, vëll. 3, f. 62.

sepse bëri ixhtihad (u përpoq në studime e hulumtime) dhe është i justifikuar. Nëse gabon, është i shpërblyer me nijetin e tij.

Një grup tjetër ka thënë të njëjtën gjë për atë që i kundërshton në çështjet e adhurimeve, që i kundërshton në çështjet e besimit (ideologjive), se çdo mosmarrëveshje e mospajtim në cilësitë e Allahut të Madhëruar, është qafir. Nëse është mospajtim për të tjera gjëra përveç kësaj, ai është i shthurur.”²⁹

Ibn Hazm, më pas përcjell këto thënie, përmend mendimin e tij dhe mendimin e dijetarëve të mëdhenj të Ehli Sunetit, duke thënë: “Një grup ka thënë se një mysliman nuk quhet i pafe e as i shthurur për një thënie që ka thënë në besim apo fetva... Kjo është thënia e Ebi Lejlasë, Ebu Hanifes, Shafiut, Sufjan Eth Theurijit, Daud ibn Aliut (Allahu qoftë i kënaqur nga të gjithë!). Këtë thënie, të gjithë e kanë mësuar prej sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Nuk dimë mendim tjetër prej tyre.”³⁰

Ahmed ibn Zahir Es Serkhasij, që është prej shokëve të ngushtë të Ebi Hasan El Ash'arij, thotë: “Kur Ebi Hasan El Ash'arij ishte afër vdekjes, në shtëpinë time në Bagdad, më urdhëroi që të mbledh shokët e tij. Unë i mblodha. Ai tha: “Jini dëshmitarët e mi që unë nuk quaj të pafe askënd që

²⁹ Ali ibn Muhamed (i njohur si ibn Hazm), “El Fasl fi el Milel ue el Ahuai ue en Nihel”, vëll. 3, f. 291, K. “El Kelamu fijmen jekfur ue la jukfer”.

³⁰ Ali ibn Muhamed (i njohur si ibn Hazm), “El Fasl fi el Milel ue el Ahuai ue en Nihel”, vëll. 3, f. 291, K. “El Kelamu fijmen jekfur ue la jukfer”.

është prej atyre që drejtohen nga Kibla për një gabim, sepse unë i kam dëgjuar ata të tregojnë për një Adhurues të vetëm dhe Islami i përfshin ata.”³¹

Po ashtu janë përcjellë nga Imam Shafiu disa thënie për këtë kuptim: “Nuk quaj heretik asnjë nga pasuesit e egos, për shkak të një gjynahu. Nuk bëj të pafe asnjë prej atyre që drejtohen nga Kibla, për shkak të një gjynahu... E pranoj dëshminë e pasuesve të risisë, përveç el khitabijetu.”³²

Ebu Xha'fer Et Tahauj, autor i librit “El Akijdeu Et Tahauijetu”, i cili gëzoi interesim te dijetarët e Ehli Sunetit, ka thënë: “Ata që drejtohen nga Kibla jonë, quhen besimtarë myslimanë, sepse pohojnë dhe pranojnë atë që solli Profeti; besojnë dhe pranojnë çdo gjë që ai ka thënë... Ne nuk quajmë të pafe askënd që drejtohet nga Kibla, për shkak të një gjynahu që nuk e quan hallall atë.”³³

Në shpjegimin e librit të Ebu Hanifes “El Fikhul Ekber”, Mulla Ali el Karij ka përcjellë mendimet e disa dijetarëve të Ehli Sunetit rreth heretizmit, duke i grumbulluar ato. Me këtë vepër ka përforcuar idenë se nuk janë të pafe ata që

³¹Sejid Abdul Husejn Sherefudin, “El Fusulul muhimeh fi te'lifil ummeh”, f. 38.

³² Sejid Abdul Husejn Sherefudin, “El Fusulul muhimeh fi te'lifil ummeh”, f. 38. El Khitabijetu është një grup i zhdukur që u themelua në gjysmën e parë të shekullit të dytë të hixhrit. Ata kanë qenë “*gulatë*” dhe pretendonin hyznizimin e imam Sadikut (paqja qoftë mbi të!). Atë e themeloi Muhamed ibn Meklas ibn ebi Zejneb el Kufij. Kur imam Sadiku e mësoi këtë gjë u distancua nga ky grup.

³³Ebu Xha'fer Et Tahauj, “El Akijedu et Tahauijetu”, K. “Bejanu akijdetu ehli sunneh uel xhemaatu”, f. 20-21.

drejtohen kah Kibla dhe se nuk mund të quhet i pafe kush beson në krijimin e Kur'anit, në pamundësinë e shikimit të Allahut dhe ai që shan e mallkon dy shehlerët (Ebu Bekrin dhe Umerin).” Këtë mendim e ka bazuar në sqarimin e "El Akaidu". Po ashtu, ai ka përcjellë thënien e sqaruesit të librit "El Meuakif", i cili përforcon se një grup dijetarësh të apologjisë dhe jurisprudencës besojnë të gjithë ata që drejtohen kah Kibla nuk janë heretikë.³⁴

³⁴ Mulla Ali ibn Sulltan el Karij, "Minhu Er reudh el Ez'her fi sherhi El fikhil el ekberi", f. 425.



UDHËHEQËSI I REVOLUCIONIT ISLAMIK, MERXHEA³⁵ FETAR, AJATULLAHU SUPREM SEJID ALI KHAMENEI

Të gjitha grupet dhe sektet islame janë pjesë e ymetit islam dhe gëzojnë privilegje islame. Krijimi i ndarjes dhe i përçarjes mes grupeve islame konsiderohet kundërshtim i mësimave të Kur'anit dhe të Sunetit të Profetit fisnik (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Po ashtu, ky veprim çon në dobësimin e

³⁵ Autoriteti me i lartë fetar tek shi'izmi.

myslimanëve dhe në dhënien e pretekstit në dorën e armiqve të Islamit. Prandaj, kjo çështje kurrë nuk është e lejuar.

Përsa i përket ofendimit të simboleve të shenjta të myslimanëve dhe të grave të Profetit, Sejid Khamenei ka dhënë këtë fetva: “Ndalohet ofendimi i simboleve të vëllezërve tanë suni, në veçanti akuzimi i bashkëshortes së Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pasi dëmton nderin e saj. Madje kjo gjë është e ndaluar për gratë e profetëve, veçanërisht për profetin madhështor, Muhamedin (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).”

Gjithashtu, në thirrjen e tij, drejtuar Haxhinjve të Shtëpisë së Shenjtë (Qabeja), ka thënë: “Edhe një herë unë ju lajmëroj, njësoj si shumë prej dijetarëve myslimanë, të cilët mbartin problemet dhe shqetësimet e ymetit islam se çdo thënie apo vepër që çon në ndezjen e zjarrit të përçarjes mes myslimanëve dhe çdo ofendim i simboleve të shenjta të çdo grupi islam apo heretizmi i një prej medhhebeve islame, është shërbim për kupolën e mosbesimit dhe politeizmit. Ky veprim është tradhti për Islamin dhe është e ndaluar në legjislacionin islam (haramun sher'an).

Betohem në Allah, se ata që mbjellin urrejtje dhe armiqësi midis shi'ave dhe sunive dhe anasjelltas, nuk janë as shi'a e as suni. Ata nuk i duan as shi'itët e as sunitët. Ata janë armiq të Islamit.

Vërtet, vehabijtë sot i quajnë të pafe shi'at, sikurse i quajnë të pafe sunitë, që janë dashamirës të Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!). Po ashtu, disa prej shi'ave ofendojnë simbolet e shenjta të Ehli Sunetit, për shkak të paditurisë së tyre apo të mos vëmendjes së tyre, apo për të mbjellë farën e përçarjes. Unë ju them juve: Kjo vepër e këtyre dy grupeve është e ndaluar në legjislacionin islam dhe është antiligjore.

Askush të mos mendojë se Ehli Bejti i Profetit është i veçantë vetëm për shi'at, por është për të gjithë ymetin islam. Kush është ai që nuk është i kënaqur me Fatime Zahranë?! Kush është ai që nuk është i kënaqur me Hasanin dhe Huseinin, zotërinjtë e të rinjve të banorëve të Xhenetit?! Kush është ai që nuk është i kënaqur me imamët e nderuar të shi'ave?! Disa mendojnë se bindja ndaj tyre është e obliguar, disa të tjerë nuk e mendojnë këtë. Mirëpo të dy grupet janë të kënaqur dhe i duan ata. Këto të vërteta duhet të perceptohen dhe të nguliten.

Mirëpo disa nuk e kuptojnë këtë çështje dhe veprojnë sipas qëllimeve të armikut dhe hamendësojnë se po bëjnë punë të mirë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Thuaj: “A doni t’ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?”**³⁶ Ata mendojnë se po bëjnë mirë, por veprojnë në favor të interesave të armikut. Kjo është karakteristika e kohës së sotme.”

³⁶ Sure “Kehf”, ajetet 103-104.



NGA MESAZHI I MERXHASË SË FESË,
AJATULLAHU I MADH, ESH SHEJKH
ABDULLAH EL XHEVADIJ EL AMULIJ,
DREJTUAR HAXHINJVE TË SHTËPISË SË SHENJTË (QABE),
NË VITIN 1434 (HIXHRI)

“... çdo ymet ka shenjtërinë e tij. Kjo shenjtëri nuk është e veçantë as për monoteistët e as për ateistët, prandaj duhet të shmanget sharja dhe ofendimi i tyre, sepse kjo

vepër, përveç se është padrejtësi shpirtërore, e bën shoqërinë të përballet me vështirësi nga ana ligjore.

Nisur nga kjo, Kur'an Kerimi e ka ndaluar këtë veprim: **"Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija. Kështu, Ne ia paraqesim të bukura çdo populli veprat e veta. Pastaj, ata do të kthehen te Zoti i tyre, i Cili do t'i lajmërojë për gjithçka që kanë bërë."**³⁷

Vërtet, procesi i luftimit është i shëmtuar. Të urdhëruarit për të mirë dhe ndalimi nga e keqja duhet të jenë në përputhje me metodologjinë e mirë dhe me rrugën e qartë. Nëse të ndaluarit nga e keqja bëhet në përputhje me metodologjinë e keqe, duhet ndaluar dhe duhet mënjeluar, ashtu siç mënjanohej të këqijat e tjera.

Gjithashtu, duhet që thirrja në të vërtetën, në të drejtën, në të mirë e në përkryerje të jetë sipas metodologjisë, e cila është në përputhje me qëllimin, sepse qëllimi nuk e justifikon mjetin. Për këtë, të urdhëruarit në të mirë, që bëhet sipas metodologjisë së keqe, duhet ndaluar, sepse gjendet lidhje reale mes metodologjisë dhe qëllimit. Rruga e drejtë nuk mund të përfundojë në një qëllim të kotë e të pavlerë. Po ashtu, rruga e devijuar nuk mund të përfundojë në një qëllim të vërtetë.

³⁷ Sure "En'am", ajeti 104.

“Kushdo që përpiket të bëjë diçka, duke i bërë mëkat Allahut, është më e largët se ajo që dëshiron dhe më e shpejtë në ardhjen e saj që i ruhet.”³⁸

Vërtet, ofendimi dhe sharja e simboleve të shenjta të çdo kombi, edhe nëse është e pavlerë, e kotë, është metodologji e keqe dhe Allahu e ka ndaluar atë.

Përmbledhja e thënieve:

- 1- Feja mbarëbotërore përmban program gjithëpërfshirës.
- 2- Më e rëndësishmja e detyrave të përgjithshme fetare është kujdesi ndaj ligjit dhe etikës ndërkombëtare.
- 3- Të ruash nderin dhe dinjitetin e njeriut dhe të heqësh dorë nga ofendimi i gjërave të shenjta të pasuesve të feve të tjera, konsiderohet prej etikave më të mira, të përgjithshme dhe popullore.
- 4- Është haram sharja dhe ofendimi i sahabëve, ofendimi i simboleve të shenjta të shi'itëve apo të sunitëve dhe përbuzja e besimit të tyre. Është detyrë e të gjithëve, veçanërisht e Haxhinjve të nderuar dhe e atyre që kryejnë Umren, që të largohen nga flakët e mosmarrëveshjeve, nga nderzja e zjarrit të përçarjes dhe nga shkatërrimi i themelit të unitetit islam, sepse të gjitha këto konsiderohen mëkate të mëdha.
- 5- Rezultati i udhëtimit tuaj shpirtëror duhet të jetë koncepti juaj për domosdoshmërinë e unitetit, ndalimin e konflikteve që krijojnë përçarje e shkatërrim. Po ashtu, largimi nga ofendimi i

³⁸ “Usulul Kafij”, vëll. 2, f. 373.

shenjtërive të çdo kombi, me qëllimin që të mos shohin e të nuhasin në botë islame veçse flladin e unitetit dhe aromën e bashkimit.



MERXHA I FESË,
AJATULLAHU
I MADH, SEJID
MUHAMED
EL HUSEJUNI
ESH SHAHRUDI

Kushdo që dëshmon se s'ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut, është mysliman. Jeta dhe pasuria e tij është e mbrojtur. Nuk lejohet vrasja e tij e as rrëmbimi i pasurive të tij. Po ashtu, nuk lejohet luftimi i myslimanëve, as heretizmi i tyre, as mbjellja e përçarjes dhe e ndarjes mes tyre. Gjithashtu, është e domosdoshme ruajtja e simboleve të shenjta të Islamit dhe duhet larguar nga cënimi i tyre. Nuk lejohet përdhosja e nderit të besimtarëve dhe as ofendimi i tyre.



MERXHA I MADH I FESË, AJATULLAHU

I MADH, SEJID MUHAMED SAID EL HAKIJM

Nuk është prej mendimit të shi'ave quatja heretikë të sahabëve dhe as i shumicës myslimane, me gjithë grupacionet e tyre të ndryshme. Kjo mbështetet te e vërteta e Islamit dhe te përcaktimi i parimeve të tij. Gjithashtu, kjo njihet nga hadithet e imamëve të shi'itëve, nga fetvatë e dijetarëve të tyre dhe nga thëniet e tyre të qarta.

Në këtë kontekst lindin dy pyetje:

- 1- Kush quhet mysliman?
- 2- Cilët janë kufijtë e heretizmit?

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Atij i takon lavdërimi!

Përgjigjet:

Së pari: Një njeri quhet mysliman, kur dëshmon dy dëshmi dhe pohon detyrimet e domosdoshme të fesë: namazin, agjërimin, Haxhin, etj. Kështu që, atë e përfshijnë rregullat e Islamit, ku marrja e pasurisë dhe derdhja e gjakut të tij janë të ndaluara.

Së dyti: Përgjigjja rreth heretizmit sqarohet nga ato që u thanë më lart.



MERXHA I FESË, AJATULLAHU I MADH, SHJEKH XHA'FER SUBHANIJ

Allahu i Madhëruar thotë: **"Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur'anin) dhe mos u përçani..."**³⁹

Allahu i Lartësuar e i Madhëruar i urdhëron myslimanët që të kapen pas litarit, fesë së Tij. Ka mundësi që

³⁹ Sure "Al Imran", ajeti 103.

përmendja e litarit të tregojë se ymeti i ndarë e i përçarë është si njeriu i rënë në pus, i cili shpëton vetëm nëse kapet nga litari që i hidhet atij brenda në pus. Për rëndësinë e kapjes pas litarit, mjafton të thuhet se, kur shpallja e Allahut përmend unitetin e fjalës dhe forcimin e rreshtave, ajo e lavdëron atë dhe urdhëron për të. Sa herë që përmend përçarjen e ndarjen, e qorton atë. Madje ajo e quan ndarjen dhe përçarjen prej sprovave qiellore: **"Thuaj: "Ai ka fuqi t'ju ndëshkojë prej së larti ose nga poshtë këmbëve tuaja, ose t'ju përçajë në grupe e të vuani nga duart e njëritjetrit..."**⁴⁰

Të gjithë myslimanët duhet të ndjekin Librin e Allahut, të unifikojnë rreshtat, të largohen nga çdo gjë që i ndan e i shpërbën ata, veçanërisht në këto ditë kur fuqitë e mosbesimit dhe të kolonizimit po bëjnë gjithçka për t'i përçarë ata, për të derdhur gjakun e tyre me duart e të tjerëve, për të realizuar qëllimet e tyre djallëzore, për të sunduar vendet islame, për të vjedhur pasuritë e tyre dhe për t'i dhënë siguri cionizmit shtypës në Palestinën e dashur dhe në Kudsin e Nderuar. Sigurisht, dukuria e heretizmit është dukuri e keqe. Të gjithë myslimanët adhurojnë Allahun e vetëm. Ata besojnë në mesazhin e të Dërguarit të fundit dhe besojnë në Ditën e Kiametit. Kjo mjafton që ata të hyjnë në Islam, siç transmeton edhe Buhariu në Sahijhin e tij, për Betejën e Khajberit. Heretizmi nuk përputhet me asnjë medhehb të imamëve myslimanë.

Kur imam A'sh'ariju ishte pranë vdekjes,

⁴⁰ Sure "En'am", ajeti 65.

grumbulloi nxënësit e tij dhe u tha: “Dëshmoni që unë nuk bëj tekfir askënd prej njerëzve të Kibles (musliman), për shkak të një gjynahu, sepse unë i kam parë ata të thonë se ka vetëm një të adhuruar dhe Islami i përfshin dhe i përgjithëson të gjithë ata. (El Jevakit uel Xheuahir, i Sha’ranij, f.58)

E gjithë kjo na detyron të respektojmë ndjenjat e të tjerëve, besimet e tyre dhe të mos u shfaqim atyre diçka që shkakton përçarje dhe trashëgon armiqësi e urrejtje. E tillë ka qenë edhe jetëshkrimi i të parëve punëmirë (selefu salih), të cilët jetuan të afërt e të dashur mes tyre.

Sigurisht, akuza e sharjes së sahabëve, e cila i është ngjitur shi’ave, është akuzë e pabazë dhe ata janë të pafajshëm. Ata ndjekin qëndrimin dhe mendimin e Imam Ali ibn Husejnit, i cili thoshte në lutjen e tij: *“O Zoti im, pasuesit e vërtetuesit e të dërguarve banorë të tokës që besojnë në të padukshmen, kur ata kundërshtojnë kryeneçët që përgënjeshtrojnë të dërguarit me dëshirën e madhe për tu afruar te të dërguarit me të vërtetat e besimit.”*⁴¹

Ue selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!

⁴¹ Imam Ali ibn Hysejn, "Sahife Saxhadije", Tiranw, 2008, f.66.

që prekin të tashmen e tij, por kërcënojnë edhe të ardhmen e tij. Të gjithë e kuptojnë se kjo situatë ka nevojë për forcimin e rreshtave, zhdukjen e përçarjes e të ndarjes, largimin nga thashethemet sektare dhe mënjanimin e ndikimeve të mospajtimeve mes medhhebeve, të cilat kanë vazhduar për një kohë të gjatë. Duhet një metodë për zgjidhjen e tyre, që të jetë kënaqësi dhe e pranuar për të gjithë. Nuk duhen ngritur debate rreth tyre, jashtë kornizave shkencore, sepse ato nuk prekin parimet e fesë dhe bazat e besimit. Të gjithë myslimanët besojnë në Allahun e Vetëm e të Pashok, besojnë në mesazhin e Profetit të zgjedhur, Muhamedit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), besojnë në Ringjalljen, besojnë se Kur'ani, të cilin e ka ruajtur Allahu nga ndryshimi dhe Suneti i nderuar i profetit, janë burimi i rregullave dhe i ligjeve të Sheriatit, besojnë në dashurinë për Ehli Bejtin (*Paqja qoftë mbi ta!*), e të tjera çështje të përbashkëta në mesin e myslimanëve, të cilat konsiderohen shtyllat e fesë, si: namazi, agjërimi, Haxhi, zekati, etj.

Këto të përbashkëta janë themeli i unitetit të fortë islam. Prandaj, duhet përqendrim në to, për të forcuar lidhjet e dashurisë e të dashamirësisë mes bijve të këtij ymeti. Duhet të punohet që mes bijve të këtij ymeti të ketë bashkëpunim paqësor, bazuar në respekt të ndërsjellë dhe larg karikimeve sektare.

Çdo i interesuar për lartësimin e Islamit dhe të myslimanëve duhet të përpiqet me gjithçka që ka dhe

mundet në rrugën e afrimit mes bijve të ymetit islam dhe në pakësimin e tensioneve të dala nga disa politika, me qëllim që të mos shtojnë mosmarrëveshjet, përçarjet dhe të mos i hapin rrugë realizimit të qëllimit të armiqve lakmues, për të sunduar e për të shtënë në dorë pasuritë e vendeve myslimane. Por, fatkeqësisht, ka disa njerëz, të cilët punojnë dhe përpiqen të përhapin ndarjen dhe përçarjen mes myslimanëve dhe të thellojnë mosmarrëveshjet sektare. Kohët e fundit këta i kanë shtuar përpjekjet e tyre pas rritjes së konflikteve politike në Lindjen e Mesme dhe ashpërsimit të konfliktit për poste e pushtet në këtë zonë. Ata ishin këmbëngulës në përpjekjet e tyre, për të shfaqur ndryshimet mes medhhebeve dhe për t'i përhapur ato. Madje, në shtesë të këtyre, ata përdorën dhe përdorin metodën e shpifjes e të gënjeshtërs, për të realizuar qëllimet e tyre keqdashëse ndaj një medhhebi, duke akuzuar ndjekësit e tij dhe duke frikësuar të tjerët prej tyre.

Në kornizat e këtij projekti, disa mjete informative, herë pas herë, nëpërmjet stacioneve satelitore, faqeve të internetit, revistave etj, shpërndajnë fetva të habitshme, të cilat i bëjnë keq medhhebeve dhe grupeve të tjera islame. (Disa prej këtyre fetvave të habitshme i vishen Sejdit të nderuar, për ta ofenduar dhe për ta nënvleftësuar pozitën e tij të lartë dhe për të nxitur konfliktin mes medhhebeve dhe grupeve islame.)

Gjithmonë Sejdi i nderuar ka porositur dhe porosit pasuesit dhe ndjekësit e tij që të bashkëpunojnë me dashuri

dhe me respekt me vëllezërit e Ehli Sunetit. Ai e ka përsëritur gjithmonë se është haram derdhja e gjakut të çdo myslimani, qoftë shi'it apo suni. Po ashtu është haram marrja e pasurisë dhe e nderit të tyre...

14 Muharrem 1428

Në përgjigje rreth të një pjese videoje, ku shfaqen disa persona, në zonën A'dhemijeh, në Bagdad, që shajnë dhe ofendojnë Omerin, Aishenë e të tjerë simbole fetare të vëllezërve tanë suni, zyra e Sejid Sistanit nxori fetvanë:

“Ky veprim është i dënueshëm dhe shumë i poshtër. Është në kundërshtim me atë që urdhërojnë imamët e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!), pasuesit e tyre. Allahu është Udhëzuesi.”



MERXHA I MADH I FESË, AJATULLAHU I MADH, ES SEJID MUSA ESH SHIBRIJ EZ ZINXHANIJ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Kushdo që shqipton dy dëshmitë, është mysliman, përveç nasibijve⁴² dhe khauarxhëve. Kushdo që shqipton dy dëshmitë, përfshihet në rregullat e Islamit, si: lejimi i

⁴² Nasibij quhen ata që kanë armiqësi e urretje për Ehli Bejtin e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familën e tij!).

martesës, meritimi i trashëgimisë, respektimi i jetës, i pasurisë së tij e të tjera rregulla e dispozita.

Ndërsa ata që mbjellin përçarjen dhe ndarjen mes rreshtave të myslimanëve dhe i bëjnë të pafe grupet dhe medhhebet islame, nuk janë myslimanë. Ata, nëse nuk janë agjentë të drejtpërdrejtë të kolonizuesve, s'ka dyshim se lëvizin në rrugën e realizimit të qëllimeve të ulëta të kolonizuesve, për të shkatërruar themelet e Islamit dhe për të shfarosur fenë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për të fshirë emrin e tij të bekuar.

Veprat e ndyra kamikaze ftohin gjokset e jobesimtarëve dhe të armiqve të përbetuar të Islamit.

Allahu i Madhëruar thotë në Librin e Tij: **“A doni t’ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënë vepra të mira?”**⁴³

Lusim Allahun e Madhëruar që t’u japë myslimanëve durim e forcë përballë intrigave të armiqve dhe të përpiqen sa më shumë për forcimin e Islamit, fesë së vulës së profetëve, Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Sejid Musa Esh Shibrij Ez Zinxhanij

3 Rexheb 1434

⁴³ Sure “Kehf”, ajetet 103-104.



MERXHA I FESË, AJATULLAHU I MADH, SHEJKH LUTFULLAH ES SAFIJ EL GOLBAJGANIJ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Kushdo që dëshmon njëshmërinë e Allahut të Madhëruar dhe mesazhin e vulës së profetëve, Muhamedit, i biri i Abdullahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është mysliman. Jeta dhe nderi i tij është i respektuar, pasuria e tij është e respektuar. Askush nuk ka të drejtë të ofendojë simbolet e

shenjtja fetare. Shpërthimet kamikaze dhe gjakderdhja e myslimanëve është prej mëkateve të mëdha.

Është detyrë e myslimanit që të reflektojë fytyrën e vërtetë të Islamit në botë, sepse feja islame është fe e mëshirës, e dashurisë dhe e butësisë. Duhet të punojnë të bashkuar për ngritjen dhe lartësimin e Islamit të dashur dhe për udhëzimin e njerëzve në çdo vend të botës. Është detyrë e myslimanëve që të sprapsin intrigat e armiqve të Kur'anit dhe të zhdukin planet e tyre nëpërmjet bashkimit dhe unitetit dhe të zbatojnë detyrat e tyre islame.

“O ju që keni besuar, nëse e ndihmoni Allahun (fenë e Tij), edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.”⁴⁴

Es selamu alejkum ue rahmetulahi ue berekatuhu!

Lutfullah Es Safij El Golbajgani

⁴⁴ Sure “Muhamed”, ajeti 7.



MERXHA I FESË, AJATULLAHU I MADH, SEJID MUHAMED ALI EL ALEUIJ EL XHERXHANIJ

Allahu i Madhëruar thotë: "O ju që keni besuar! Hyni të gjithë në paqe dhe mos i shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përбетuar."⁴⁵

Mesazhi i Islamit bazohet te arsyeja dhe dialogu. Ai përforcon braktisjen e çdo mosmarrëveshjeje, përçrjeje dhe

⁴⁵ Sure "El-Bekare", ajeti 208.

akuzimi në çdo kohë. Allahu i Madhëruar thotë në Librin e Tij: **"...Të keqen ktheje në të mirë..."**⁴⁶

Dhe: **"Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija..."**⁴⁷

Në ditët e sotme shohim se planet e armiqve synojnë Islamin, Fjalën e Allahut, për të fshirë të gjitha mesazhet qiellore dhe për të vendosur qeverisjen e djallit në tokë. Nuk duhet të ecim në rrugën që i siguron interesin kolonializimit global dhe cionizmit botëror, duke këmbëngulur në mosmarrëveshjet, në mospajtimet dhe duke krijuar atmosferë armiqësore.

Të gjitha grupet islame duhet të jetojnë në paqe. Të gjithë duhet të bashkohen përballë armikut të përbashkët, ashtu siç ishin myslimanët në të shkuarën, ku grupet e ndryshme islame jetonin së bashku, me respekt dhe paqe, edhe pse çdo grup kishte besimin e tij të posaçëm. Mes tyre zhvilloheshin diskutime logjike dhe tubime dialogu.

Ajo që veprojnë heretikët, të cilët përhapen me argumente të ndryshme dhe që urrejnë medhhebet islame, veçanërisht shi'at, në vende të ndryshme, si: në Pakistan, Afganistan, Irak, Siri, Indonezi, janë të papranueshme. Veprat e tyre bazohen në vrasje, në masakra ndaj myslimanëve në vende të ndryshme. Të gjitha këto janë të dënueshme. Me këto vepra që bëjnë, ata vetëm se gëzojnë dhe lumturojnë armiqtë e Islamit. Në të vërtetë, ata lëvizin sipas hartës që


⁴⁶ Sure "Fusilet", ajeti 33.

⁴⁷ Sure "En'am", ajeti 108.

ka vizatuar kolonializmi global dhe kundërshtojnë qartë Kur'anin e Shenjtë, i cili thotë: **“Mos i merrni miq jobsimtarët.”** Ata i konsiderojnë sionistët miq dhe veprojnë kundër shi'ave në bashkëpunim me ta.

E lusim Allahun e Madhëruar që ta mbrojë shoqërinë islame nga përçarja dhe armiqësia!

Muhamed Ali El Aleuij El Husejni El Xhixhanij



**MERXHA I FESË, AJATULLAHU I MADH,
EH SHEJKH MUHAMED EL FADIL
EL LANKERANIJ**

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Të gjitha këto grupe konsiderohen islame, me përjashtim të ndonjërit që mohon të domosdoshmet e fesë së drejtë, ose mos e lejoftë Allahu, ofendon apo shan, apo flet keq për imamët e pastër (Paqja qoftë mbi ta!)



MERXHA I FESË, I NDJERI AJATULLAHU I MADH, ES SEJID JUSUF EL MEDENIJ ET TEBRIZI

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!


Islami nuk e lejon ofendimin dhe përçmimin e besimeve, të cilësdo feje qofshin, sidomos të medhhebeve islame. Çdo vepër që çon në krijimin e mosmarrëveshjeve dhe të konflikteve mes ymetit islam dhe i shkakton dëme

materiale myslimanëve, është e ndaluar (haram) dhe në kundërshtim me shariatën (legjislacionin).

Operacionet vetëvrasëse që kryhen ndaj myslimanëve, në vende të ndryshme të botës, lëndojnë zemrën e sjellësit të shariatit dhe zemrën e çdo njeriu të lirë. Ato nuk janë në përputhje me të vërtetën e fesë islame, e cila është fe e butësisë dhe e mëshirës. Këto veprime vetëvrasëse kamikaze njollosin pamjen dhe fytyrën e Islamit në botë.

E lusim Allahun e Madhëruar që t'i ruajë dhe t'i mbrojë myslimanët nga e keqja e të padrejtëve dhe e shkatërrimtarëve!

Sejid Jusuf El Medenij Et Tebrizij



MERXHA I FESË, AJATULLAHU I MADH, ESH SHEJKH HUSEJN EL MUDHAHIRIJ

Ajo që keni shkruar në pyetjen tuaj është vërtet e hidhur dhe të gjithë myslimanët në botë duhet të jenë të vëmendshëm ndaj saj dhe të vendosin rrugëzgjidhje për të, sidomos (veçanërisht) dijetarët e medhhebeve islame dhe udhëheqësit e vendeve islame.

Kolonializmi global dhe armiqhtë e Islamit po zgjerojnë pushtetin e tyre ditë për ditë dhe po forcohen më shumë. Kjo po ndodh për shkak të ndezjes së mosmarrëveshjeve në rreshtat e myslimanëve, veçanërisht mospajtimet ideologjike.

Kur'ani i Shenjtë dëshmon dhe përforcon se këto mosmarrëveshje e mospajtime janë si zjarri dhe dënimi që mbulon shoqërinë islame, siç thuhet në thënien e Allahut të Lartësuar: **“Thuaj: “Ai ka fuqi t’ju ndëshkojë prej së larti ose nga poshtë këmbëve tuaja, ose t’ju përçajë në grupe e të vuani nga duart e njëri-tjetrit. Shih si ua shpjegojmë shpalljet, që ata të mund të kuptojnë!”**⁴⁸

Ai përforcon se, nëse kolonizuesit dhe armiqhtë e humanizmit do të sundojnë mbi njerëzimin, do të ndodhë përhapja e mosmarrëveshjeve. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Me të vërtetë që Faraoni madhështoj në Tokë dhe banorët e saj i kishte përçarë në grupe...”**⁴⁹

Shërimi dhe rrugëzgjdhja e kësaj është vetëm të vepruarit sipas urdhrave të Kur'anit të Shenjtë, i cili thotë: **“...ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush...”**⁵⁰

Bazuar në këtë dhe ashtu siç e kemi thënë, e kemi përforcuar disa herë, nuk lejohet as ligjërisht e as logjikisht nxitja dhe përhapja e mosmarrëveshjeve ndaj cilido personi apo grupi. Po ashtu, nuk lejohet nxitja dhe përhapja e përçarjes mes medhhebeve, veçanërisht

⁴⁸ Sure “En’am”, ajeti 65.

⁴⁹ Sure “Kasas”, ajeti 4.

⁵⁰ Sure “Al Imran”, ajeti 64.

ofendimi dhe sharja e gjërave të shenjta dhe ideologjitë e myslimanëve. Nuk lejohet të bëhet përçarje mes pasuesve të Profetit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshi mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Veprat shkatërruese, vetëvrasëse, të cilat i veprojnë një grup tekfivistësh e mendjengurtë, çojnë në vrasjen e myslimanëve të pafajshëm, janë vepra të shëmtuara, të fëlliqura, antinjerëzore, lëndojnë zemrën e çdo njeriu të lirë. Sigurisht, këto veprime janë qëllimi i armiqve të Islamit dhe myslimanëve. Kolonializmi global përpiket t'i detyrojë myslimanët që ta pasojnë atë nëpërmjet ndezjes dhe përhapjes së mosmarrëveshjeve dhe mospajtimeve dhe nëpërmjet veprave që mbjellin farën e përçarjes e të ndarjes. Sigurisht, ndjekja e armiqve dhe e kolonizuesve është prej mëkateve të mëdha.

E lusim Allahun e Madhëruar që t'i ruajë myslimanët nga e keqja e mosmarrëveshjeve dhe e përçarjes! E lusim Atë që t'i mbarësojë të gjithë për të punuar për bashkimin dhe forcimin e rreshtave të myslimanëve!

Ue selamun alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!

Husejn El Mudhahirij

4 Xhemadul Uula, 1434 hixhri



MERXHA I FESË, AJATULLAHU I MADH, ESH SHEJKH NASIR MEKARIM ESH SHIRAZIJ

E kemi thënë gjithmonë se uniteti mes myslimanëve dhe afrimiteti mes medhhebeve islame janë prej çështjeve më të domosdoshme në çdo kohë, sidomos në kohën e sotme.

Sigurisht, ofendimi i gjërave të shenjta të të tjerëve nuk lejohet në Sheriat. Myslimanët, suni dhe shi'it, duhet të jenë të kujdesshëm e të vëmendshëm, që të mos bien në kurthet e armiqve të Islamit dhe të mos përhapin asnjë mosmarrëveshje e përçarje sektare.

Veprimet vetëvrasëse dhe derdhja e gjakut të të pafajshmëve, është prej mëkateve të mëdha. Ato janë

vërtetësi e qartë e shkatërrimit në tokë dhe çojnë në Xhehenemin e përjetshëm. Ato reflektojnë pamjen e kundërt e të papranueshme të Islamit, i cili është mëshirë dhe butësi.

E lusim Allahun që t'i udhëzojë të gjithë mëkatarët dhe të humburit!

Ue selamun alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!



**MERXHA FETAR, AJATULLAHU I MADH,
ES SEJID ABDUL KERIJM EL MUSAUIJ
EL ERDEBILIJ**

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Allahu i Madhëruar thotë: “Vërtet, ky është ymeti juaj, ymet i vetëm, e Unë jam Zoti juaj, prandaj më adhuroni Mua!”⁵¹

⁵¹ Sure “Enbija”, ajeti 92.

Vërtet, uniteti dhe vëllazëria janë prej mirësive më me vlerë të Allahut, të cilat Allahu i përmend në Librin e Tij të Shenjtë: **“...Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tua e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër...”**⁵²

Si është e mundur që një person të thotë se është prej ndjekësve të Profetit të mëshirës (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), e quan veten e tij mysliman dhe nuk respekton jetën e të tjerëve, as nderin e as pasurinë e tyre?!

Ata që mendojnë se po mbrojnë Islamin nëpërmjet dhunës dhe gjakderdhjes, janë mashtrues, gënjeshtarë. Ata janë bërë mjet për realizimin e lakmive e të synimeve të armiqve të ymetit islam.

Në ditët e sotme, përçarja mes myslimanëve, jo vetëm që i zhvesh myslimanët nga krenaria, madhështia e qetësia, por është shkak i ofendimit dhe i poshtërimit të Islamit në sytë e të tjerëve. Ndjekësit e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) duhet ta kenë përgjegjësi këtë para vëllezërve të tyre myslimanë.

Ne krenohemi që jemi prej pasuesve të Imam Ali ibn Ebu Talibit (Paqja qoftë mbi të!) dhe se e vërteta e Shi'izmit është rrugëtimi i Imamit të besimtarëve. Ky Imam kurrë nuk lejonte që të shaheshin e të ofendoheshin të tjerët. Ai i ndalonte fjalët e këqija e dashakeqëse. Ai burrë i madh, gjithë jetën e tij e kaloi duke punuar për të realizuar qëllimet e Islamit e të myslimanëve dhe ka qenë

⁵² Sure “Al Imran”, ajeti 103.

gjithmonë në shërbim të tyre. Ai ftonte në pajtim, në vëllazërim dhe në bashkim myslimanët. Ai bënte thirrje për zhdukjen e konflikteve që ndodheshin mes tyre.

Shpresojmë nga të gjithë myslimanët, pa përjashtim, sidomos nga pasuesit e medresesë së Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) që të kujdesen e të ruajnë ymetin islam dhe ta mbajnë larg nga mosmarrëveshjet sektare, të cilat kanë turbulluar kohën e sotme. Shpresojmë prej tyre që mësimet e Shpalljes dhe këshillat e Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të jenë në krye të punëve të tyre.

O Allah, bëj që kurthet e jobesimtarëve të zhduken!

Zyra e Ajatullahut të madh El Musauij El Erdebilij
- Fetvatë



MERXHA I FESË, AJATULLAHU I MADH, SHEJKH BESHIR EN NEXHEFIJ

Me emrin e Allahut, të Lartësuarit!

Së pari: Kushdo që pohon Njësinë (teuhidin), beson në profetësinë e Muhamedit, i biri i Abdullahut (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se mesazhi i tij është vula e mesazheve dhe e profetësisë, beson në Ringjallje dhe nuk refuzon asgjë nga ato që dihen, që janë prej konstanteve në Islam, është mysliman dhe e

përfshijnë rregullat islame. Gjaku, pasuria dhe nderi i tij është i mbrojtur dhe është detyrë e të gjithë myslimanëve që të mbrojnë gjakun, pasurinë dhe nderin e tij.

Së dyti: Ai që dëshmon dy dëshmitë: dëshminë e Njësimit (teuhidit) dhe dëshminë e profetësisë së Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dëshmon Ringjalljen, nuk refuzon asgjë nga të domosdoshmet e Islamit, nuk lejohet heretizmi i tij. Është transmetuar nga Profeti (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndalimi rreptësisht i kësaj gjëje. Ai që përhap përçarje mes medhehebeve, apo e quan të pafe një fraksion a sekt që beson dhe pohon ato që përmendëm më lart, ai ose është injorant (xhahil), ose hiqet si xhahil, ose është kundërshtues i Islamit dhe përçan myslimanët për t'i shërbyer pushtuesit të pafe në përçarje dhe në ndarjen e myslimanëve.



MERXHA I FESË, AJATULLAHU I MADH, SHEJKH HUSEJN NURIJ EL HAMEDANIJ

Kushdo që thotë dy dëshmitë, me përjashtim të armiqve të Ehli Bejtit dhe el khauarixhëve, është mysliman dhe atë e përfshijnë rregullat e Islamit, si: trashëgimia, mbrojtja e gjakut të tij, e pasurisë së tij, e nderit të tij e të tjera rregulla. Ata që përhapin përçarjen mes rreshtave të ymetit islam dhe i quajnë të pafe myslimanët, janë jashtë të vërtetës së fesë. Ata, nëse nuk janë drejtpërsëdrejti shërbëtorë të kolonializmit, sigurisht punojnë për realizimin e qëllimeve dashakeqëse, të humbura e

humbëse të atij kolonializmi, i cili, me këto veprime, synon zhdukjen e Islamit, fesë së Profetit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dhe synojnë fshirjen e emrit të tij.


Allahu i Madhëruar thotë në Librin e Tij: **Thuaj: “A doni t’ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, përpjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënë vepra të mira?”**⁵³

Dashtë Allahu që myslimanët të jenë më të fortë se në të shkuarën, me qëllim që të lartësohet sa më shumë emri i kësaj feje të drejtë e të vërtetë dhe të mbrohet krenaria e saj, që myslimanët të kuptojnë kurthet që ngrenë armiqtë. Prandaj, myslimanët duhet të përpiqen sa më shumë në këtë rrugë dhe të jenë të kujdesshëm që të mos ofendojnë simbolet e shenjta të sekteve të ndryshme islame, sepse kjo çon në përhapjen e përçarjes e të hipokrizisë në mesin e bijve të ymetit islam. Sigurisht që kjo përçarje i sjell dobi vetëm armiqtë.

Çdo vepër që çon në gjakderdhjen e të pafajshmëve, është e ndaluar (haram).

Husejn Nuri Hamedani

⁵³ Sure “El-Kehf”, ajetet 103-104.



MERXHA I FESË, AJATULLAHU I MADH, SHEJKH HUSEJN UAHIJÐ EL KHURASANI

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Çdokush që dëshmon Njësinë e Allahut të Madhëruar, mesazhin e vulës së profetëve, hazretit Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është mysliman. Kështu që, jeta e tij është e respektuar, nderi i tij është i respektuar dhe pasuria e tij është e respektuar, njësoj si jeta, nderi dhe pasuria e atij që përfaqëon Islamin. Është detyrë e myslimanëve që të sillen

mirë me ata që dëshmojnë dy dëshmitë, edhe nëse besojnë se janë të pafe. Edhe nëse ju bëjnë padrejtësi, ju nuk duhet të devijoni nga rruga e së vërtetës dhe e drejtësisë. Nëse dikush prej tyre sëmuret, shkoni e vizitoheni atë. Nëse vdes, shoqërojeni xhenazen e tij, nëse ka nevojë për ju, përmbushjani nevojën dhe dorëzoni thënies së Allahut të Madhëruar: **“O ju që keni besuar! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju.”** (Sure “El-Maide”, ajeti 8) dhe veproni sipas urdhrit të Tij: **“...Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: “Nuk je besimtar...”⁵⁴**

Ue selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!

⁵⁴ Sure “En-Nisa”, ajeti 94.



AJATULLAH, SHEJKH MUHAMED MEHDI EL ASIFIJ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1- Kush dëshmon dy dëshmitë dhe pohon kufijtë e Allahut dhe rregullat e Tij të domosdoshme në Islam, për të cilat myslimanët kanë mendim të përbashkët, është mysliman. Derdhja e gjakut dhe marrja e pasurisë së tij janë të ndaluara. Ka ardhur nga Profeti Muhamed (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*): “Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit derisa të thonë “La ilahe il’allah”, s’ka Zot tjetër përveç Allahut. Kur ta thonë atë,

gjaku dhe pasuria e tyre janë të mbrojtura prej meje, vetëm atëherë kur e meritojnë dhe llogaria e tyre është tek Allahu.”⁵⁵

2- Ata që vrasin myslimanët, pa u bazuar në asnjë kufi apo dispozitë të sheriatit, në Libër apo në Sunet, në një hadith unanim, Profeti i ka cilësuar të pafe. Në hytben e “Haxhit të Lamtumirës”, në xhaminë El Khajf, në Mina, Profeti ka thënë: “Vërtet, pasuritë tuaja, gjaku juaj dhe nderet tuaja janë të shenjta, si shenjtëria e kësaj dite, e këtij vendi dhe e këtij muaji...” Pastaj ka thënë: “Mos u ktheni pas meje të pafe e të vrisni njëri-tjetrin...”⁵⁶

3- Nuk lejohet përhapja e përçarjes sektare, as urrejtja e nxitja për keq dhe as ndarja mes myslimanëve. Nuk lejohen veprimet që çojnë në shpërbërjen e rreshtave të myslimanëve, as përhapja e mosmarrëveshjeve e as ndërprerja e lidhjeve dhe e marrëdhënieve mes myslimanëve, sepse Allahu thotë: **“Kapuni të gjithë pas litarit (fesë) të Allahut e mos u përçani...”**⁵⁷ S’ka dyshim se keqbërja dhe ofendimi i të shenjtave dhe i simboleve të medhhebeve e sekteve të tjera islame është prej faktorëve

⁵⁵Këtë hadith e ka transmetuar Ahmedi në Musnedin e tij, në shumë vende; Bajhaku në Sunein e tij, Buhariu dhe Muslimi në Sahihun e tyre dhe një grup hafizash të haditheve profetike, me zinxhirë të saktë e të rregullt të shi’at dhe të sunitët.

⁵⁶Mutefikun alejhi. E ka përcjellë Imam Ahmedi në Musnedin e tij, në shumë vende; Nisai në Es Sunenu El Kubra, ibn Haban në Es Sahijh, po ashtu e kanë përcjellë Muslimi dhe Buhariu në Sahijhet e tyre dhe një grup i madh hafizash të haditheve profetike, me rrugë të saktë në literaturën e të dy grupeve (shi’a dhe suni).

⁵⁷ Sure “Al Imran”, ajeti 102.

më të mëdhenj të përçarjes dhe për këtë na ka ndaluar Allahu i Madhëruar.

4- Allahu na ka urdhëruar për mirësjellje, për të jetuar në harmoni, për bashkëpunim, për solidaritet, për të shkëmbyer vizita dhe për dashuri ndaj myslimanëve të tjerë, përveç nasibijëve. Hadithet e ardhura nga Profeti rreth këtyre janë të shumta dhe shumica e tyre janë të sakta. Po ashtu, rreth kësaj tematike ka hadithe të ardhura edhe nga Ehli Bejti (Paqja qoftë mbi ta!), të cilat i kemi përmendur në librin “El Fitnetu Et Taifijeh”.

5- E gjitha kjo nuk do të thotë që të mos ketë dialog për çështjet e besimit e të jurisprudencës mes dijetarëve myslimanë dhe medhhebeve të ndryshme, me një gjuhë shkencore dhe në një klimë dialogu tematiko-shkencor. Sigurisht, ky dialog çon në udhëzim, në përsosje dhe në njohjen më të mirë të parimeve të jurisprudencës islame në mesin e myslimanëve. Kjo është ajo që na nxit Islami. E lusim Allahun e Madhëruar që t'i unifikojë rreshtat e myslimanëve, fjalët dhe qëndrimet e tyre! E lusim Atë që t'i përkrahë thirrësit në afrimet e në unitet mes myslimanëve!

**Muhamed Mehdi El Asifij,
28 Xhemadu Thanij 1434 hixhrit
Nexhefi i Nderuar**



AJATULLAH, SHEJKH MUHAMED HASHIM SALIHI MUDERIS

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Islami e përforcon shumë tematikën e unitetit mes myslimanëve. Ky interesim ka arritur deri në atë shkallë, saqë vjen pas mohimit, politeizmit të Allahut të Madhëruar. Madje thuhet se Islami është ndërtuar mbi dy mbështetëse: fjala e teuhidit (njësimit) dhe njësimi i fjalës. Bazuar në këtë, cënimi i shpirtrave të myslimanëve, pasurisë dhe ndereve të tyre konsiderohet prej mëkateve të mëdha dhe prej të ndaluarave në fenë tonë islame. Po

ashtu, Islami nuk e lejon ofendimin e besimeve, cilado fe apo medhheb prej medhhebeve të ndryshme islame qofshin.

Përsa i përket veprave vetëvrasëse (kamikaze), që kryhen kundër myslimanëve dhe që çojnë në marrjen e shpirtirave, në vende të ndryshme të botës, ato janë të ndaluara në fe, sepse janë vërtetësi e shkatërrimit në tokë dhe prej mëkateve të pafalshme. Kushdo që i kryen ato, do të jetë banor i përhershëm i Xhehenemit. Myslimanët, shi'it dhe suni, duhet të jenë të kujdesshëm ndaj intrigave dhe kurtheve të armiqve të Islamit, ndaj atyre që mbjellin farën e përçarjes e të ndarjes dhe ndaj heretizmit.

Është detyrë e të gjithë myslimanëve që t'u pasqyrojnë popujve të tjerë pamjen e vërtetë të fesë së drejtë islame, e cila është fe e dëshirës, e butësisë, e dashurisë dhe e ngritur mbi parimin: "Diskuto me atë që është më e mira". Po ashtu, është detyrë e tyre bashkëpunimi për të ruajtur vëllazërinë dhe përhapjen e Islamit të pastër.

Muhamed Hashim Salihij



AJATULLAH, SHEJKH ASIF MUHSINIJ

*Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!
Atij i takon përherë lavdërimi!*

Së pari: Ai që thotë se Allahu është Një i Vetëm e i Pashoq, beson në mesazhin e zotërisë tonë, Muhamed Mustafa (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*), se ai është vula e profetëve dhe i të dërguarve dhe beson në Ditën e Kiametit, është mysliman.

Së dyti: Agresiviteti ndaj shpirtrave të të gjithë myslimanëve, pasurisë së tyre dhe ndereve të tyre absolutisht është haram (i ndaluar)

Së treti: Myslimani është vëlla i myslimanit. Është detyrë e çdo myslimani që të mbrojë vëllazërinë, të

përhapë Islamin dhe tolerancën në çështjet e papajtueshme.

Së katërti: Mbjellja e mosmarrëveshjeve mes ndjekësve të medhehbeve të ndryshme islame konsiderohet tradhti ndaj fesë islame.

Asif Muhsinij – Afganistan



AJATULLAH, SHEJKH MUHAMED RIZA

MEHDEUIJ KUNI

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Kushdo që dëshmon dy dëshmitë (dëshminë e njësimimit të Allahut të Madhëruar dhe të profetësisë së vulës së profetëve, Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*), është mysliman, përveç atyre që kanë armiqësi ndaj Ehli Bejtit të profetit dhe e shfaqin atë.

Pasuesit (shi'at) e Ehli Bejtit (Paqja qoftë mbi ta!) janë të ngarkuar që të bashkëpunojnë me të gjithë myslimanët, me vëllazëri dhe me dashuri. Të shoqërohen me ta në namazet me xhemat, të përcjellin xhenazet e tyre, të vizitojnë të sëmurët e tyre, të shoqërohen e të miqësohen

me ta dhe t'i ndihmojnë ata. Ata duhet të shmangen nga përçarja dhe urrejtja ndaj myslimanëve të tjerë, sepse ky është qëllimi i armiqve të Islamit.


Po ashtu, ata janë të ngarkuar që të respektojnë të shenjtat e të gjitha medhhebeve. Duhet të njohin përçarjet që krijojnë armiq të Islamit, të cilët i shqetëson uniteti islam. Allahu i Madhëruar thotë: **"Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (fenë) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në sajë të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë."**⁵⁸

O Allah bëj që të triumfojë Islami dhe pasuesit e tij dhe poshtëroje mosbesimin dhe pasuesit e tij! Vërtet, heretizmi i myslimanëve dhe vrasja e tyre, dhe e çdo lloj grupi qofshin, dhe marrja e pasurive të tyre, është e ndaluar (haram). Këto vepra konsiderohen prej mëkateve të mëdha. Allahu i Madhëruar thotë: **"...kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit..."**⁵⁹

Muhamed Riza Mehdeuij Kunij
Sekretar i dijetarëve mbrojtës në Teheran
Kryetar i ekspertëve të udhëheqjes

⁵⁸ Sure "Al Imran", ajeti 102.

⁵⁹ Sure "El-Maide", ajeti 32.



AJATULLAH, SHEJKH MUHAMED EL JEZDIJ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Allahu i Madhëruar thotë: **“Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija...”**⁶⁰

Kur’ani i Shenjtë e ndalon qartë sharjen dhe mallkimin e atyre që janë të devijuar nga rruga e drejtë, sepse kjo i bën ata që të thonë fjalë të papërshtatshme për Allahun e Madhëruar. Sikur ta përsiatim këtë ajet dhe të mendojmë thellë në të, do të shohim se ai ka caktuar një rregull të përgjithshëm, që është ndalimi i veprave që nxisin

⁶⁰ Sure “En’am”, ajeti 108.

armiqësi ndaj të tjerëve dhe i shtyjnë ata që të kryejnë vepra të shëmtuara. Prandaj, mallkimi i atyre që gëzojnë respekt tek njerëzit dhe sharja e tyre, sidomos ata që trupëzojnë simbole fetare, është vepër e gabuar, që mund të çojë në vrasjen e disa njerëzve, apo në shpërdorimin e pasurisë së tyre, apo mësymjen e nderit të tyre dhe sigurisht që është haram dhe kundër sheriatit islam. Kush e bën këtë, është përgjegjës i kësaj vepre në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër. Nuk ka dallim se në çfarë forme është: fjalim, poezi, apo ilahi, apo vajtim, apo teatër apo film. Qofshin të vërteta apo të supozuara. Nuk ka dallim në natyrën e këtij veprimi, sepse ai shkakton vrasjen e njerëzve, ofendimin e simboleve të shenjta të tyre, shkatërrimin e pasurive të tyre dhe lejimin e çnderimit të tyre.

Bazuar në ato që përmendëm, në këtë botë asgjë nuk mbetet e fshehtë, për shkak të mjeteve të përparuara të informacionit, si: interneti, radioja, televizioni, stacione satelitore, telefona modernë, shumica e të cilave janë në shërbim të shërbimeve inteligjente të spiunazhit. Përdorimi i këtyre për përhapjen e mallkimit e të sharjes së njerëzve të mëdhenj të medhhebeve fetare, sidomos personaliteteve të njohura islame, siç janë khalifët në fillim të Islamit, fëmijët e profetit, gratë e profetit, nuk lejohet, sepse, kjo është zanafilla e mosmarrëveshjeve dhe e shumë konflikteve në vende të ndryshme islame. Sigurisht, që kjo është e ndaluar (haram). Argument për këtë është Suneti praktik i imamëve të udhëzimit (Paqja qoftë mbi ta!) dhe

veprat e tyre, veçanërisht Ali ibn Ebu Talibi (Paqja qoftë mbi të!).

Përgjithësisht, mallkimi dhe sharja kurrë nuk ndikojnë në sqarimin e të vërtetës. Është e domosdoshme që konstatimi i një të vërtete nëpërmjet dijetarëve dhe mendimtarëve, në shkolla, në universitete e në qendra të ndryshme të dijes e të shkencës, duhet të bëhet larg fanatizmit, politikës e grupimit partiak.

Shpresojmë që të gjitha grupacionet islame, të interesohen më shumë ndaj këtyre çështjeve, nëpërmjet njohjes së realitetit të kohës dhe rrethanave të botës së sotme. Duhet të veprojmë me logjikë e arsyetim, me qëllim që Allahu të na ruajë, inshaAllah.

Muhamed Jezdi
Kryetar i grupit të mësuesve në hauzatet e dijes në
qytetin e Kunit

حرمة تكفير المسلمين

والإساءة إلى مقدسات الأمة الإسلامية

في فتاوى و آراء مراجع الدين و العلماء المسلمين الشيعة

تيرانا: 2015

اسم الكتاب: حرمة تكفير المسلمين والإساءة إلى مقدسات الأمة الإسلامية
في فتاوى و آراء مراجع الدين و العلماء المسلمين الشيعة

المترجم: الشيخ وُلُنتُ (عباس) مريا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

الاخراج النهائي & ديزاينر الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - ألبانيا

تيرانا: 2015

تيراژ: 1000 نسخة